



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore
01Nr. 111/09-22856 /21
Kaçanik; 09.09.2021

Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore për zbatim të paragrafit 12 të nenit 34 të Ligjit për zyrtarët publik dhe nenit 18 të Rregullores (qrk) nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, bënë këtë:

SHPALLJE PUBLIKE

për një (1) ekspert të jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitetet

Detyrat dhe përgjegjësitë

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i Komisionit të pranimin dhe do të kryejë detyrat e tij, ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren (qrk) nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Kriteret e kërkuara

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës.
- Të kenë përvojë pune të paktën katër (4) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pese (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Pagesa: Pagesa është fikse 250 euro e cila iu paguhet ekspertit për çdo procedure të konkurimit në të cilën është i angazhuar.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Së bashku me aplikacionin kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. CV
2. Fotokopje të diplomës të vërtetuar;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Dëshminë për përvojën e punës
5. Dëshminë se nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e një vepre penale
6. Deklaratë se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
7. Deklaratë se nuk është i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Formularët e aplikimit merren në Qendrën për shërbim me qytetar dhe në web-faqen komunale dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar kati për dheshë në objektin e Komunës në Kaçanik.

Afati për pranimin e aplikacioneve është prej datës 10.09.2021 deri më 14.09.2021

Pas vlerësimit të kandidatëve, Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore publikon listen e kandidatit fitues në web-faqen komunale.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”;

Të gjitha dokumentet e dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati, përmes aplikacionit, vetdeklaron se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkak për përjashtimin nga procedura.

Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë Njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

**Udhëheqëse e personelit
Hidajete Guri**

